



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2019

Lënda: Kthim përgjigje.

Rruga: _____

Në përgjigje të kërkesës Tuaj, datë 02.05.2019, administruar nga Bashkia Shkodër, me Nr.7484 Prot., datë 06.05.2019, me objekt : “Informacion nëse rezulton të keni projekte publike në zhvillim, plane zhvillimore me interes publik, keni dhënë leje ndërtimore, jeni në proces të dhënies së ndonjë leje ndërtimore, apo çdo të drejtë tjetër reale, në pasurinë me sipërfaqe 109.000 m² ZK.2597, fshati Mali-Kolaj, Njësia Administrative Velipojë, Bashkia Shkodër, sipas plan rievimit për individualizimin e pasurie në akt ekspertimin e datës 28.06.2010”, bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju bëjmë me dije se:

Bashkia Shkodër për zonën objekt kërkesë nuk rezulton të kete projekte publike në zhvillim apo plane zhvillimore me interes publik.

Sa i përket lejeve të ndërtimit, Ju informojmë se, që pas reformës territoriale miratuar me ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, që përfshinë edhe ish-komunën Velipojë në njësiti administrative përbërse të Bashkisë Shkodër, (pas konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015) në zonën objekt kërkesë nuk ka miratuar asnjë leje ndërtimi, ndërsa për periudhën para reformës territoriale, dokumentacioni në arkivën e Bashkisë Shkodër është i dokumentuar sipas subjekteve përfitues të lejes së ndërtimit.

Duke ju falenderuar,

KRYETAR
Voltana Ademi